



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.289 Akti

Nr.186 Vendimi

Tiranë, më 23.07.2019

V E N D I M

Trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Pamela Qirko	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, pas hedhjes së shortit të datës 15.03.2019, caktimit të kryetarit, më datë 21.03.2019, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 23.07.2019, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Arjana Fullani, ish gjyqtare në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Nenet 14 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Neni 64, pika 1, germa “a” dhe neni 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 3, të nenit 4 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, znj. Arjana Fullani ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, duke qenë kështu subjekt rivlerësimi.
- 4.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, subjekti i rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur, më datë 15.03.2019. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri z. Olsi Komici.
- 5.** Në mbledhjen e trupit gjykues në datën 21.03.2019, u caktua me mirëkuptim si kryesues i trupës gjykuese znj. Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani.
- 6.** Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, ka filluar në respektim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.
- 7.** Znj. Arjana Fullani ka ushtruar funksionin e gjyqtares së Gjykatës së Lartë në periudhën korrik 2008 - korrik 2017,
- 8.** Me vendimin nr. **, datë 29.06.2017, Gjykata e Lartë ka vendosur deklarinimin e mbarimit të mandatit 9-vjeçar të ushtrimit të detyrës për znj. Arjana Fullani si gjyqtare e Gjykatës së Lartë, në bazë të pikës 2, të nenit 139, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

9. Më datë 31.07.2017, znj. Arjana Fullani ka dorëzuar në protokollin e Gjykatës së Lartë¹ kërkesën me lëndë “Njoftim për dorëzimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë për shkak të mbarimit të mandatit”.

10. Kryetari i Gjykatës së Lartë, me shkresën² e datës 31.07.2017 ka informuar Presidentin e Republikës se në bazë të pikës 2, të nenit 139, të Kushtetutës, trupa gjyqësore e Gjykatës së Lartë u mblodh më datë 29.06.2017 dhe vendosi të deklarojë të përfunduar mandatin e anëtares së Gjykatës së Lartë, znj. Arjana Fullani si edhe faktit se në mënyrë individuale kjo gjyqtare ka paraqitur një shkresë drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, me të cilën e njofton për dorëzimin e detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë, për shkak të mbarimit të mandatit.

11. Më datë 30.04.2018, znj. Arjana Fullani ka depozituar në Komision, shkresën me lëndë “Njoftim”³, me anë të së cilës ndër të tjera njofton Komisionin se, bazuar në të drejtën që i njeh ligji (neni 62 i ligjit 96/2016) nuk ka paraqitur kërkesë për t’u emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit dhe se ka filluar ushtrimin e veprimtarisë ekonomike private në profesionin e avokatit duke u regjistruar si person fizik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 29.01.2018, e pajisur me Nipt ****. Në këto kushte, ajo vlerëson se statusi i saj si gjyqtare ka mbaruar për shkak të ligjit dhe si rrjedhim në kushtet e përfundimit të këtij statusi, si dhe në zbatim të nenit 3/16 dhe nenit 58, të ligjit 84/2016, vlerëson se nuk është më subjekt i ligjit 84/2016.

12. Në përgjigje të kërkesës së znj. Arjana Fullani, Komisioni, me shkresën⁴ e datës 14.05.2018, ndër të tjera ka vlerësuar se, megjithëse znj. Fullani i ka mbaruar mandati si anëtare të Gjykatës së Lartë, ajo për shkak të ligjit vijon të gëzojë statusin e magjistrates. Bazuar në nenin 62, pika 1, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me përfundimin e mandatit të saj si anëtare e Gjykatës së Lartë, znj. Fullani gëzon të drejtën që me kërkesën e saj, të jetë ende pjesë e sistemit të drejtësisë në nivel apeli. Për sa më sipër, Komisioni ka informuar znj. Fullani se, ndërpreja e procedurave të rivlerësimit nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mund të bëhet vetëm nëse vërtetohen kushtet e parashikuara nga neni G, i Aneksit të Kushtetutës.

13. Më datën 03.12.2018⁵, znj. Arjana Fullani i është drejtuar sërish Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke kërkuar pushimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, për shkak se pretendon se nuk është subjekt rivlerësimi.

14. Me shkresën⁶ e datës 23.01.2019, Komisioni i ka vënë në dispozicion Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ-së) të gjithë praktikën shkresore⁷ të administruar për ish-anëtares e Gjykatës së

¹ Protokolluar në Gjykatën e Lartë me nr. *** prot., datë 31.07.2017.

² Shkresa me nr. *** prot. Datë 31.07.2017.

³ Shkresa protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.04.2018.

⁴ Shkresa e Komisionit nr. *** prot, datë 14.05.2018.

⁵ Shkresa protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 03.12.2018.

⁶ Shkresa e Komisionit nr. *** prot, datë 23.01.2019.

⁷ Korrespondencat e mbajtura me subjektin dhe shkresa të tjera të administruara që kanë të bëjnë me mbarimin e mandatit të kësaj gjyqtareje.

Lartë, znj. Arjana Fullani të listuara si më sipër, duke i kërkuar vlerësimin dhe qëndrimin e tyre mbi procedurat për statusin e magjistratit për këtë subjekt.

15. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën⁸ e datës 25.04.2019 informon Komisionin se, me vendimin nr. **, datë 24.04.2019, mbështetur në nenin 179, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në nenet 62 dhe 64, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Arjana Fullani, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel apeli.

16. Në vijim, Komisioni me shkresën⁹ e datës 30.04.2019 i kërkoj KLGJ-së dokumentacionin e plotë që lidhet me vendimin për mbarimit të statusit të znj. Arjana Fullani, përfshirë dhe aktin e heqjes dorë nga statusi i magjistratit, nga kjo ish-gjyqtare.

17. Nga verifikimi i praktikës së dërguar nga KLGJ-ja¹⁰ konstatohet se, (1) me shkresën¹¹ e datës 03.04.2019, KLGJ i është drejtuar znj. Arjana Fullani duke i kërkuar konfirmim për të drejtën e saj për tu caktuar në një pozicion nivel apeli, njëkohësisht duke e informuar për vendet vakante dhe; (2) me shkresën¹² të datës 08.04.2019, znj. Arjana Fullani ka konfirmuar faktin se “nuk dëshiron të emërohet si gjyqtare në nivel Apeli as tani dhe as në të ardhmen”.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TE RIVLERËSIMIT

a. Orientimi i Kolegjit të Posaçem të Apelimit:

18. Kolegji i Posaçëm Apelimt në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij si dhe pasojave juridike që passjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj: i) Presidenti i Republikës; ii) Këshilli i Lartë Gjyqësor; iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare¹³.

b. Verifikimi i statusit të magjistratit dhe faktit se kemi të bëjmë me subjekt të ligjit 84/2016:

⁸ Shkresa e KLGJ-së nr. *** prot. datë 25.04.2019, protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 25.04.2019.

⁹ Shkresa e Komisionit nr. *** prot. datë 30.04.2019.

¹⁰ Shkresa e KLGJ me nr. *** prot., datë 10.05.2019, protokolluar në KPK me nr. *** prot., datë 10.05.2019.

¹¹ SHkresa e KLGJ-së, nr. *** prot. 03.04.2019.

¹² SHkresa e dates 08.04.2019 e protokolluar në KLGJ me nr. *** prot., datë 08.04.2019.

¹³ Referohuni paragrafëve 96 dhe 97 të vendimit nr.***, datë 11.06.2018 të KPA-së.

19. Referuar kuadrit ligjor për mandatin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe statusit të gjyqtarëve, sipas ligjit të kohës në momentin e mbarimit të mandatit, znj. Arjana Fullani ish-gjyqtare e Gjykatës së Lartë, rezulton të ketë fituar statusin e magjistratit në kuptim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtej e në vijim referuar si Ligji i Statusit). Ky konstatim bazohet në nenin 139, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (këtej e në vijim referuar si Kushtetuta) si edhe në nenet 62, 161 (Dispozita kalimtare për magjistratët në Gjykatën e Lartë) dhe nenin 169 (dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve) të ligjit nr.96/2016.

20. Pika 3 e nenit 139 të Kushtetutës përcakton se, procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj (bën fjalë për ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë të cilëve u ka mbaruar mandati).

21. Pika 1 e nenit 161, të ligjit nr.96/2016, përcakton se, gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Lartë do konsiderohet magjistrat, sipas këtij ligji. Ndërsa pika 1, e nenit 169 e po këtij ligji përcakton se, pjesa mbi të drejtat dhe detyrimet e magjistratit zbatohet menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen.

22. Pika 1 e nenit 62, pika 1, e Ligjit për Statusin parashikon se në përfundim të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë ose në raste të tjera, ku ligji parashikon të drejtën për t’u caktuar në një pozicion apeli, magjistrati ka të drejtë për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion.

23. Në fakt, terminologjia e përdorur në pikën 3 të nenit 139, të Kushtetutës, nuk është e njëjtë me atë të përdorur në nenin 62 të ligjit nr.96/2016, kjo sa i përket të drejtës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në përfundim të mandatit, ndërsa në ligj nuk bëhet fjalë për “emërim”, por për “caktim në një pozicion në nivel apeli”.

24. Marrë për bazë ligjin nr.96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, koncepti i “emërimin” është i ndryshëm me atë “të caktimit në pozicion”, veprim ky që mund të bëhet vetëm për një të emëruar.

25. Duke qenë se znj.Arjana Fullani, ka qenë në detyrë me mandat të kufizuar (në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë), në interpretim të ligjit nr.96/2016, mbarimi i mandatit dhe dorëzimi i detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk ka passjellë automatikisht mbarimin e statusit të magjistratit, për ish gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Arjana Fullani.

26. Statusi i magjistratit mbaron në rastet e përcaktuara shprehimisht nga pika 1 e nenit 64, të ligjit 96/2016, ku përfundimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk përcaktohet si një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit.

27. Përkundrazi, referuar pikës 5 të nenit 136 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr.96/2016, në harmoni me përcaktimin pikës 4 të nenit 61, dhe pikës 1 të nenit 62, të po këtij ligji, për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që iu mbaron mandati, njihet:

- i. e drejta për të qëndruar në detyrë deri në emërimin e pasardhësit;

ii. e drejta për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel gjykate apeli.

28. Nisur nga arsyetimi i mësipërm Komisioni ka vlerësuar se, me përfundimin e mandatit të znj. Arjana Fullani si anëtare e Gjykatës së Lartë, ajo ka gëzuar të drejtën që, me kërkesën e saj, të ishte ende pjesë e sistemit të drejtësisë si gjyqtare në nivel gjykate apeli. Për këtë arsye, Komisioni nuk ka ndërprerë më herët¹⁴ procedurën e rivlerësimit ndaj znj. Arjana Fullani, duke vlerësuar se ajo ishte subjekt rivlerësimi deri në momentin e shfaqjes së vullnetit të saj dhe të nxjerrjes së vendimit nga KLGJ-ja për mbarimin e statusit të magjistratit, për ish-gjyqtaren.

c. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje:

29. Sikurse e kemi evidentuar edhe më sipër, Gjykata e Lartë, në datën 29.06.2017, ka vendosur deklarimin e përfundimit të mandatit të gjyqtarës të Gjykatës së Lartë, për znj. Arjana Fullani.

30. Pika 5 e nenit 136, e Kushtetutës parashikon se: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët ‘c’, ‘ç’, ‘d’ dhe ‘dh’”. Referuar kësaj dispozite, në harmoni me nenin 139 të Kushtetutës Komisioni çmon se, ish-gjyqtari i Gjykatës së Lartë duhet të qëndrojë në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve kur: (1) jep dorëheqjen; (2) shkarkohet sipas dispozitave të nenit 140 të Kushtetutës; (3) vërtetohen kushtet e pazgjidhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit dhe; (4) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

31. Vetë institucioni i Gjykatës së Lartë, në datën 04.07.2017 në njoftimin e bërë për publikun në faqen e ëb-it të saj [ëëë.gjykataelartë.gov.al](http://eeë.gjykataelartë.gov.al), lidhur me deklarimin e përfundimit të mandatit të disa gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku bëhet fjalë edhe për mbarimin e mandatit të znj. Arjana Fullani, ndër të tjera informon publikun se: “...në bazë të nenit 139/5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit.”

32. Rezulton se, zj. Arjana Fullani, në datën 31.07.2017 ka njoftuar¹⁵ kryetarin e Gjykatës së Lartë për dorëzimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë për shkak të mbarimit të mandatit. Por, konstatohet se nuk është shprehur me akt për vullnetin e saj për dorëheqje, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 136, dhe nenit 139, të Kushtetutës.

33. Kryetari i Gjykatës së Lartë, me gjithë mos depozitim të aktit të duhur të dorëheqjes, sipas parashikimit ligjor, duket se ka interpretuar aktin e njoftimit për dorëzimin e detyrës si një “dorëheqje” të paraqitur nga znj. Arjana Fullani, duke anashkaluar kërkesat e parashikuara në ligj.

34. Komisioni vlerëson se, subjekti i rivlerësimit znj. Arjana Fullani duhet të qëndronte në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç në rast se konstatohej një nga shkaqet e parashikuara në nënparagrafët ‘c’, ‘ç’, ‘d’ dhe ‘dh’, të pikës 1 të nenit 139 të Kushtetutës.

35. Me aktin “njoftim”¹⁶ të depozituar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit më datë 30.04.2018 subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka parashtruar duke vlerësuar se: “...parashikimi i bërë në nenin 136/5 të Kushtetutës (ndryshuar me ligjin nr. 76/2016) rregullon gjithë situatën ligjore të

¹⁴ Mbështetur në kërkesat e bëra nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁵ Protokolluar në Gjykatën e Lartë me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2017.

¹⁶ Protokolluar në Komisionin me nr. *** prot., datë 30.04.2018

gjqytarëve të rinj të Gjykatës së Lartë të cilët do të zgjidhen sipas dispozitave të këtij ligji, të cilët ndryshe nga anëtarët ekzistues të kësaj Gjykate të emëruar me Kushtetutën e vitit 1998, kanë të drejtë të qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e pasardhësit.”

36. Gjithashtu, znj. Arjana Fullani, nëpërmjet aktit të mësipërm, ka informuar Komisionin se nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për t’u emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit dhe se ka filluar ushtrimin e veprimtarisë private, në profesionin e avokatit duke u regjistruar si person fizik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 29.01.2018, paisur me Nipt ****. Në këto kushte, ajo vlerëson se statusi i saj si gjyqtare i ka mbaruar për shkak të ligjit dhe ka pretenduar se nuk është subjekt i ligjit të Vettingut nr. 84/2016.

37. Pas informimit të bërë nga Komisioni¹⁷ se ndërprerja e procedurave të rivlerësimit mund të bëhet vetëm nëse vërtetohen kushtet e parashikura nga neni G, i Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit me aktin¹⁸ e datës 03.12.2018, *“kërkesë për pushim/ndërpreje të procesit të rivlerësimit”* ndër të tjera ka parashtruar, se nuk është subjekt i ligjit të rivlerësimit dhe se ka kërkuar pushimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit bazuar në nenin 95, të Kodit të Procedurës Administrative, i cili përcakton se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”*

38. Ndërsa, pas kërkesës së bërë nga KLGJ-ja¹⁹, për të konfirmuar të drejtën e saj për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli, zj. Arjana Fullani më aktin²⁰ e datës 08.04.2019 ka konfirmuar se ***nuk dëshiron të emërohet si gjyqtare në nivel Apeli as tani e as në të ardhmen.***

39. Rezulton se, znj. Arjana Fullani, në cilësinë e ish-gjyqtares së Gjykatës së Lartë, të cilës i ka mbaruar mandati gjatë periudhës tranzitore të ligjit, pas momentit të dorëzimit të detyrës, nuk ka kërkuar formalisht realizimin e të drejtës së saj për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel gjykate apeli.

40. Nga ana tjetër, znj. Fullani ka zgjedhur, tashmë prej më shumë se 1 viti, të ushtrojë aktivitet tregtar, në fushën e veprimtarisë “shërbime, konsulencë, ekspertizë ligjore, avokat”, duke u regjistruar në QKB si person fizik.

41. Ndërkohë, me përfundimin e periudhës tranzitore të ligjit, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Arjana Fullani përmes aktit me shkrim²¹ të datës 08.04.2019, ka konfirmuar mungesën e interesit përse i përket realizimit të të drejtës së saj për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel gjykate apeli.

42. Nisur nga sa më sipër Komisioni çmon se, znj. Arjana Fullani, me refuzimin e të drejtës së saj për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, ***me shfaqjen e vullnetit të saj se heq dorë nga kjo e drejtë edhe në të ardhmen,*** që passjell dhe mbarimin e statusit të magjistratit, **ka**

¹⁷ Protokolluar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 14.05.2018.

¹⁸ Protokolluar në Komision me nr.*** prot., datë 03.12.2018.

¹⁹ Shkresa e KLGJ-së e nr. *** prot., datë 03.04.2019.

²⁰ Protokolluar në KLGJ me nr. *** prot., datë 08.04.2019.

²¹ Protokolluar në KLGJ me nr. *** prot., datë 08.04.2019.

konsumuar në mënyrë indirekte aktin e dorëheqjes dhe se ky akt është paraqitur në një prej institucioneve të caktuara me ligj në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Si rrjedhim Komisioni çmon se, vullneti i subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqje është i pavesuar.

ç. Ligji i zbatueshëm për ndërprejen e procedurës së rivlerësimit:

43. Në gërmën “a” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron/përfundon kur ai jep dorëheqjen.

44. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si më poshtë vijon: *“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”*

45. Neni “G”, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

46. Neni 56, i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit, ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.*

47. Paragrafi 43, i Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.”*

48. Komisioni është vënë në dijeni të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për deklarimin e mbarimit të satatusit të magjistratit, për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Arjana Fullani, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli.

49. Komisioni çmon se, subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit "G" të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin "G" të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Arjana Fullani, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, më datë 23.07.2019

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes Shuli

Kryesues

Olsi Komici

Relator

Pamela Qirko

Anëtar

Etmonda Hoxha
Sekretare gjyqësore